



European
Union
Kosovo

Pensionimi i parakohshëm i shërbyesve civilë



Janar 2021

KOSOVO 2.0

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE



Pensionimi i parakohshëm i shërbyesve civilë

Janar 2021

Deklaratë mohimi:

Ky publikim është botuar me asistencë të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe Kosovo 2.0 dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Përmbajtja

3 Hyrje

4 Statistika rreth moshës së shërbyesve civilë

7 Kostoja financiare e pensionimit të parakohshëm

8 Përfundim

9 Aneks



KOSOVO 2.0



Hyrje


Ligji për zyrtarët publikë¹, i cili ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2019, parasheh edhe pensionimin e parakohshëm të shërbyesve civilë. Sipas nenit 63 të këtij ligji, dy vite para moshës së rregullt të pensionimit, shërbyesit civilë mund të dalin në pensionim të parakohshëm me kërkesë të tyre ose me vendim të institucionit. Pagesa për pensionim të parakohshëm është 70% e pagës bazë deri në moshën e pensionimit. Por, për të detajizuar procedurat e pensionimit të parakohshëm, qeveria nxjerr akte nënligjore.

Në muajin gusht të vitit 2020, Qeveria e Kosovës ka aprovuar Rregulloren për lirim dhe pensionimin e parakohshëm nga shërbimi civil². Rregullorja përcakton procedurat e pensionimit të parakohshëm me kërkesë të shërbyesit/es civil/e ose me iniciativë të institucionit.

Kur shërbyesit civilë kërkojnë pensionim të parakohshëm, kërkesën e dorëzojnë tek njësi për burime njerëzore, e cila nëse pas verifikimit plotëson kushtin ligjor për pensionim të parakohshëm, brenda pesë ditësh këtë kërkesë e dërgon tek udhëheqësit e drejtpërdrejtë të shërbyesve civilë të cilët japin mendimin e tyre brenda 10 ditësh. Njësi për burime njerëzore e dorëzon kërkesën së bashku me mendimin e udhëheqësve të drejtpërdrejtë tek udhëheqësit më të lartë administrativ, të cilët kanë 30 ditë kohë për të aprovuar ose refuzuar kërkesën. Në rast të refuzimit të kërkesës, shërbyesit civilë mund të ankohen në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës (KPMShCK).

Pensionimi i parakohshëm i shërbyesve civilë me kërkesë të institucionit bëhet në rastet kur reduktohet personeli pas një riorganizimi, bashkimit me një institucion tjetër ose mbylles së institucionit apo shuarjes së pozitave. Në rast se shërbyesit civilë nuk janë të kënaqur me vendimin e institucionit për pensionim të parakohshëm, mund të ankohen në KPMShCK.

Figura 1. Procesi i pensionimit të parakohshëm sipas kërkesës së shërbyesve civilë



¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.06/L-114 për zyrtarët publik, publikuar më 11 mars 2019. Burimi: <https://bit.ly/30o5ODE>

² Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Rregullore nr.13/2020 për lirim dhe pensionimin e parakohshëm nga shërbimi civil. Publikuar më 27 gusht 2020.


Burimi: <https://bit.ly/2JD7aLx>

Statistika rreth moshës së shërbyesve civilë

Nga 82,885 punonjës në organizata buxhetore³ në nëntor 2020, shërbyes civilë janë 22,129 (26.7% e të gjithë punonjësve). Prej tyre, 66% e shërbyesve civilë janë burra (14,633 burra) dhe 34% gra (7,496 gra).

Mosha mesatare në shërbimin civil është 47.5 vjet. Mosha mesatare e burrave në shërbimin civil është 48.3 vjeç, kurse për gra 45.9. Mesatarja e viteve të përvojës së punës në shërbimin civil është 16.6 vjet, prej të cilave 15.8 për gra dhe 17 për burra. Kurse mediana e moshës për burra është 47.6 vjet, kurse për gratë 45.7.

Figura 2. Numri i shërbyesve civilë sipas moshës dhe gjinisë



Në kohën kur është bërë ky hulumtim, Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Njësia e Thesarit në Ministrinë e Financave nuk kanë poseduar të dhëna nga vitet e mëhershme se sa ka pasur kërkesa për pensionim të parakohshëm apo nëse ka pasur raste kur institucionet kanë inicuar procedurat për pensionim të parakohshëm⁴.


Nga numri i përgjithshëm i shërbyesve civilë, 3,118 persona janë mbi moshën 60 vjeçare (14.1%). Ndërsa 1,091 shërbyes civilë janë 63 vjeç ose më të vjetër (7.9% e numrit të përgjithshëm të shërbyesve civilë). Në disa organizata buxhetore numri i shërbyesve civilë mbi moshën 60 vjeçare arrin deri në 30.1% të numrit të përgjithshëm të shërbyesve civilë brenda organizatës. Pesë institucione⁵ nuk kanë asnjë të punësuar mbi moshën 60 vjeçare.

³ Organizatat buxhetore nënkuptojnë institucionet e nivelit qendror, komunat, agjencionet e pavarura të cilat financohen nga Buxheti i Kosovës.

⁴ Intervistë me Naser Shamollin – Drejtor i Departamentit Ligjor në Ministrinë e Punëve të Brendshme, 14 dhjetor 2020; Intervistë me Ahmet Ismaili – Drejtori i Thesarit në Ministrinë e Financave, 15 dhjetor 2020.


⁵ Agjencia për Informim dhe Privatësi, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave, Këshilli Kosovar për Trashigimi Kulturor.

Figura 3. Përqindja e shërbyesve civilë 60+ vjet sipas organizatave buxhetore



Sa i përket moshës mesatare të shërbyesve civilë sipas institucioneve, ajo lëviz mbi moshën 50 vjeçare⁶ deri në moshën 36 vjeçare⁷.

Figura 4. Mosha mesatare e shërbyesve civilë sipas organizatave buxhetore



Mosha mesatare e shërbyesve civilë është më e lartë në komuna (47.5 vjeç) se sa në institucionet qendrore (45.1) ose institucionet e pavarura (43.3).

6 Komunat: Istog, Viti, Klinë Gjilan, Deçan, Suharekë, Pejë, Podujevë, Dragash, si dhe Universiteti i Prishtinës.

7 Agjencia për Informim dhe Privatësi, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave.

Kostoja financiare e pensionimit të parakohshëm

Duke u bazuar në vlerësimin e ndikimit buxhetor për Rregulloren për pensionimin e parakohshëm të shërbyesve civilë, qeveria parasheh që kostoja buxhetore për pensionimet e parakohshme mund të mbulohet në kuadër të buxhetit të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil.

Tabela 1. Buxheti i Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil 2020-2022

Vitet	2020	2021	2022
Pagat dhe shtesat	166,200	167,031	167,066
Mallrat dhe shërbimet	125,000	125,000	125,000
Totali	291,200	345,068	346,642

Duke u bazuar në këtë vlerësim financiar kuptohet se Qeveria e Kosovës nuk parashikon se do të ketë kërkesa të shumta për pensionim të parakohshëm, por as nevojë për pensionim të parakohshëm sipas kërkesës së institucionit.

Duke u bazuar në pagën mesatare bazë të shërbyesve civilë mbi 63 vjeç, e cila sipas të dhënave të siguruara nga Thesari është 386.69 euro, mund të bëhet një vlerësim i përafërt i koston së pensionimit të parakohshëm të shërbyesve civilë.

Tabela 2. Modelim i koston buxhetore për pensionimin e parakohshëm të shërbyesve civilë mbi moshën 63 vjeçare

Shkalla e pensionimit të parakohshëm të shërbyesve civilë mbi moshën 63 vjeçare	Numri i shërbyesve civilë	70% e pagës mesatare bazë	Periudha maksimale në pension të parakohshëm (muaj)	Kostoja buxhetore
10%	109	270.7€	24	708,151€
20%	218	270.7€	24	1,416,302€
30%	327	270.7€	24	2,124,453€
40%	436	270.7€	24	2,832,605€
50%	545	270.7€	24	3,540,756€
60%	655	270.7€	24	4,255,404€
70%	764	270.7€	24	4,963,555€
80%	873	270.7€	24	5,671,706€
90%	982	270.7€	24	6,379,857€
100%	1,091	270.7€	24	7,088,009€

Nëse të gjithë shërbyesit civilë mbi moshën 63 vjeçare dalin në pension të parakohshëm 24 muaj para moshës ligjore të pensionimit, atëherë kjo do t'i kushtonte buxhetit të Kosovës 7 milionë euro. Nëse për shembull vetëm 10% e shërbyesve civilë mbi moshën 63 vjeçare kërkojnë pensionim të parakohshëm, kostoja maksimale do të ishte 708 mijë euro.

Nëse, përmes ndonjë strategjie apo ndryshimeve ligjore, qeveria vendos që të ulë moshën e pensionimit të parakohshëm për të gjithë ata mbi moshën 60 vjeçare, me qëllim që pozitat e tyre të mos zëvendësohen për të ulur numrin e të punësuarve në institucionet publike, kostoja vjetore për pensionet e parakohshme mund arrijë deri 10 milionë euro.

Natyrisht, jo të gjitha pozitat e shërbyesve civilë të cilët dalin në pension mund të mos zëvendësohen. Kjo është problematike sidomos në nivelin lokal, ku në disa komuna në pesë vitet e ardhshme 30% e shërbyesve civilë pritet të dalin në pension.

Përfundim

Kosova ka shkallën më të lartë të të punësuarve në sektorin publik si përqindje e punësimit të përgjithshëm. Pak më shumë se 30% e të punësuarve në Kosovë punojnë në sektorin publik. Mesatarja për vendet e Ballkanit është 27.2%, në vendet e Bashkimit Evropian është 23.7%, kurse mesatarja e punësimit në sektorin publik në vendet e OECD-së është 21.1%.⁸

Andaj, reforma në administratën publike duhet të përfshijë edhe uljen e numrit të shërbyesve civilë. Në një raport të vitit 2015, Instituti GAP ka rekomanduar ngrirjen e procedurave për punësime të reja në administratën publike, mos zëvendësimin e pozitave që mbesin të lira pas pensionimit të punëtorëve dhe risistemim të vendeve të punës.⁹


Për këtë qëllim, Qeveria e Kosovës, me strategjinë e re për reformën në administratën publike, duhet të parashih edhe uljen e numrit të shërbyesve civilë. Për të inkurajuar pensionimin e parakohshëm me vetë iniciativë të shërbyesve civilë, qeveria duhet të konsiderojë edhe uljen e moshës për pensionim të parakohshëm apo edhe pagesë të plotë të pagës deri në arritjen e moshës ligjore të pensionimit të rregullt.

8 OECD. Government at a glance. Western Balkans 2020 – Kosovo, 2020. Burimi: <https://bit.ly/3nMargc>


9 Instituti GAP. Madhësia e Administratës Publike. Korrik 2015. Burimi: <https://bit.ly/2LzOltF>

Aneks


Aneks 1. Mosha mesatare e shërbyesve civilë sipas komunave




Aneks 2. Mosha mesatare e shërbyesve civilë në institucionet qendrore



Aneks 3. Mosha mesatare e shërbyesve civilë në institucionet e pavarura dhe gjyqësore



Aneks 4. Shërbyes civilë që kanë arritur moshën 63 vjeçare







Projekti “Inovacioni për mediat e qëndrueshme dhe angazhimin qytetar” i financuar nga BE, implementohet nga:

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE  gap 

KOSOVO 2.0







European
Union
Kosovo